TURIZMI I AVENTURËS- TREDI AKTUAL I DESTINACIONEVE TURISTIKE NË SHQIPËRI

(RAST PILOT VIA DINARICA – PJESA SHQIPTARE)

Dr. Florina Pazari

f.pazari@umb.edu.al

Dr. Elda Mamoçi

student.dean@umb.edu.al

M.Sc.Esmeralda Hasani

e.hasani@umb.edu.al

ABSTRACT

Albania, although a country with a small area, has many natural and cultural resources, that offerthe possibility of different types of tourism. The rich and diverse nature of Albania offers the opportunity to develop various activities and sports in nature. Tourism in Albania plays an important role in the economic development of the country, generating employment and economic income of related sectors. In the last decade, the number of tourists (domestic and foreign) has increased significantly, which has led to the growth and improvement of tourist infrastructure, development of new tourist destinations and alternative types of nature-based alternative tourism, in function of sustainable development tourism. In the framework of sustainable tourism development, adventure tourism has already become a trend of tourist destinations in our country. More and more tourists are avoiding mass gatherings and are looking for explorations of new destinations, with an authentic culture and numerous outdoor activities and new experiences. The increase in demand comes as a result of a number of factors such as: increasing urbanization and population growth in cities, which are looking for recreational and outdoor recreation areas; enhanced marketing of experienced adventure

experiences; increased commercialization of outdoor and adventure recreation, etc.

The Albanian Alps, part of the Via Dinarica White Trail, are among the main and most popular destinations for the development of adventure tourism in the country and the region. The high altitudes above sea level, the picturesque view of the peaks above 2000 m, the diversity of outdoor sports, the cultural authenticity offered by the villages in the Albanian Alps, etc., are some of the adventurous attractions for tourists. The announcement aims to identify and promote adventure sports tourist destinations in the country, analyze the current trend towards outdoor tourism and unforgettable adventure sports experiences. The Albanian Alps have been selected as a pilot area, as part of Via Dinarica, commercialization of adventure tourism, recognition in the international tourism market, etc.

***Key words**: adventure, outdoors activities, tourism, destination*

ABSTRAKT

Shqipëria, ndonëse nnë vend me sipërfaqe të vogël, ka pasuri të shumta natyrore dhe kulturore, duke ofruar mundësinë e llojeve të ndryshme të turizmit. Natyra epasur dhe e larmishme e Shqipërisë ofrojn mundësinëe zhvillimit tëaktiviteteve dhe sporteve të ndryshme në natyrë. Turizmi në Shqipëri luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit, duke gjeneruar punësim dhe të ardhura ekonomike të sektorëve ndërlidhur me to.Dekadën e fundit numri i turistëve (vendas dhe atyre të huaj) është rritur ndjeshëm, gjë e cila ka çuar në rritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës turistike, zhvillim tëdestinacioneve të reja turistik si dhe llojevetë turizmit alternative të bazuar në natyrë, në mënyrë që të kemi një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit.

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, turizmi i aventurës është shëndërruar tashmë në një trend të destinacioneve turistike, në vendin tonë. Gjithnjë e më shumë turistët po shmangin grumbullimet

masiv dhe po kërkojnë eksplorime të destinacioneve të reja, me një kulturë autentike dhe aktivitete të shumta në natyrë dhe përvoja të reja. Rritja e kërkesës vjen si rezultat e një sërë faktorësh si:rritjen e urbanizimit dhe shtimit të popullsisënë qytete, të cilat janënëkërkim të zonave çlodhëse dhe argëtuese në natyrë;marketing i shtuar i përvojave të aventurave ë përjetuara; komercializim i shtuar i rekreacionit në natyrë dhe atij aventuresk, etj. Alpet Shqiptare, pjesë e Via Dinarica White Trail,janë ndërdestinacionet kryesore dhe më të njohura për zhvillimin e turizmit të aventurës në vend dhe rajon. Lartësitë e mëdha mbi nivelin e detit, pamja piktoreske e majave të larta mbi 2000 m, larmishmëria e sporteve outdoor, autenticizmi kulturor që ofrojnë fshatrat në alpet shqiptare, etj, janë disa nga atraktivitetet aventureske për turistët.Kumtesa ka për qëllim evidentimin dhe promovimin e destinacioneve turistike të sporteve të aventurës në vend, analizimin e trendit aktual drejt turizmit në natyrë si dhe përvojave të paharruara të sporteve të aventurës. Alpet Shqiptare janë përzgjedhur si një zonë pilot, si pjesë e Via Dinarica, komercializimit të llojeve të turizmit të aventurës, njohjes në tregun turistik ndërkombëtar, etj.

Fjalët kyçe: *aventurë, aktivitete outdoor, turizëm,destinacione*

HYRJE

Turizmi dhe industritë ndërlidhur me to kanë pësuar një zhvillim të hovshëm dekadat e fundit në vend dhe rajon, duke zënë një peshë të konsiderueshme në ekonomitë e tyre.Numri i turistëve në Shqipëri është rritur nga viti në vit, duke e kthyer Shqipërinë në një destinacion të rëndësishëm turistik në rajon. Në periudhën 2014-2018, mbërritjet e shtetasve të huaj në Shqipëri ishin afërsisht 23.6 milion turistë. Gjatë vitit 2018 Shqipëria shënoi rritjen më të shpejtë në sektorin e turizmit midis vendeve të Europës Juglindore, me mbi 5.3 milion turistëndërkombëtare. Në vitin 2019, rreth 21.2% e PBB në vend u sigurua nga sektori i turizmit dhe udhëtimeve, gjë e cila u shoqërua me rritje të nivelit të të punësuarve në sektorin e turizmit (22.2% e të të punësuarve në total). Interesi gjithnjë e më i lartë për të vizituar Shqipërinë shihet dhe nga tendencat e shtimit

të netëve të qëndrimit të shtetasve të huaj dhe atyre vendas në strukturat akomoduese. Të dhënat e INSTATtregojnë, që numri i netëve të qëndrimit njeh një trend në rritje nga viti në vit, ku mesatarisht turistët e huaj qëndrojnë 5.6 netë, ndërsa ato për arsye biznesi 4.3 netë. Në kuadër të llojeve të turizmit që zhvillohen në Shqipëri, turizmi i aventurës është një nga format e turizmit me një rritje të shpejtë dhe inters gjithmonë e në rritje si nga turistët vendas ashtu edhe ato të huaj. Turizmi i aventurës është një treg i dukshëm në zhvillim, që përfaqëson një nga segmentet e tregut me rritjen më të shpejtë, me potencialin për t'u bërë shumë popullor dhe me rendiment të lartë. Termi ‘aventurë’ është një lloj eksperience, që përfshin eksitimin personal, i cili mund të përkufizohet si "aktivitete udhëtimi dhe argëtimi që blihen me shpresën se do të prodhojnë një përvojë aventureske të dobishme".Shqipëria, ndonëse një vend me sipërfaqe të vogël, ka një pasuri të madhe të ofertës turistike duke i dhënë mundësi për zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit, natyror dhe atij kulturor. Bukuritë natyrore malore, vija bregdetare e paprishura, plazhe të bukura, të identifikuara nga vizitorët ndërkombëtarë si "plazhet e fundit të egra të Mesdheut", male të larta dhe të thepisurasi dhe qytete antike me vende historike, muze si dhe zona arkeologjike dhe kështjellat, e rendisin Shqipërinë si një destinacion turistik që nuk duhet humbur. Turistët që vizitojnë Shqipërinë, gjithnjë e më shumë po shmangin turizmin masiv dhe po kërkojnë eksplorime të destinacioneve të reja, me një kulturë autentike dhe aktivitete të shumta në natyrë.Ky trend vlerësohet dhe nga numri I vizitorëve të cilët frekuentojnë Zonat e Mbrojtura të Shqipërisë, veçanërisht Parqet Kombëtare dhe Peizazhet e Mbrojtura të Burimeve të Menaxhuara.Ky trend ka ardhur si rezultat i sërë pasojash si: rritjes së urbanizimit; marketingut të shtuar të përvojave të aventurave përmes formave të ndryshme të argëtimit masiv; rritja e komercializimit në lidhje me rekreacionin në natyrë; përmirësim I cilësisë së jetës; rrijta e kërkesa të turistëve për përvoja të reja, etj.

Larmishmëria e aktiviteteve që zhvillohen në natyrë, puna e operatorëve turistik, por jo vetëm, në lidhje me organizimet e udhëtimeve me kohjëzgjatje të shkurtër, çmim të arsyeshëm për grupe të ndryshme sociale, etj, janë disa faktorë të shtuar të cilët kanë ndikuar në rritjen e lëvizje turistike me focus natyrën dhe aventurën.

Grafik nr.1: Numri i vizitorëve në Zonat e Mbrojtura në Shqipëri



Burimi:Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Shqipëria ka një marketing të shtuar në lidhje me promovimin e vendit për turizmin "me interes të veçantë" (përfshini turizmin e aventures), ku turistët mund të zbulojnë vende magjepëse duke u mbështetur në natyrën e egër dhe diversitetin kulturor. Ky produkt është ai që ka më shumë potencial nga të gjithë pasi shumica e turistëve ndërkombëtarë që vizitojnë vendin synojnë turizmin e bazuar në natyrë dhe atë të aventurës.

OFERTA NATYRORE E SHQIPËRISË DHE LLOJET E TURIZMIT NATYROR DHE ATIJ TË AVENTURËS

Pozita gjeografike në të cilën ndodhet Shqipëria, pasuritë natyrore, veçoritë gjeologjike dhe gjeomorfologjike, biodiversiteti i pasur, pasuritë ujore, etj, janëpikat e forta të zhvillimit të turizmit natyror në Shqipëri. Vlerat ekologjike, shkencore, biologjike, hidrologjike, etj që pasuritë natyrore të Shqipërisëdisponojnë, kanë bërë qërreth 16% e territorit të vendit është shpallur Zonë e Mbrojtur dhe mbrohet me ligj. Këto zona të mbrojtura, janë një mundësi e mirë për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, veçanërisht ekoturizmit, turizmit rural, turizmit të aventurës, etj. Popullsia lokale që jetojnë në afërsi të këtyre zonave ende ruajnë një një stil jetese tradicionale dhe kanë një trashëgimi kulturore të pasur dhe autentike, e cila është një vlerë e shtuar e këtyre pasurive natyrore dhe

formave të mundshme të turizmit që mund të zhvillohen. Zonat natyrore dhe ato rurale në Shqipëri ofrojnë mundësi për zhvillimin e ekoturizmit dhe turizmit të aventurës si rafting, hedhje me parashutë, ciklizëm malor, peshkim, trekking, hiking (ecje në natyrë) ngjitjet alpinistike, shëtitje me kuaj, eksplorim të shpellave, etj.

Harta 1: Harta fizike dhe e mbulesës bimor të Shqipërisë



Burimi: Harta fizike dhe bimore e Shqipërisë

Përpunimi hartografik: F.Pazari

Ndryshimi i trendeve të interesit të turistëve, mbi forma alternative të aktiviteteve dhe sporteve në natyre, ka bërë që një numër i konsiderueshëm i tureve turistike të përshkojnë zona gjeografike të vendit të panjohura në tregun turistik ndërkombëatr dhe të paprekura nga ture masive. vargmalet e Korabit dhe Lurës; zonat malore përreth Tiranës, malësitë Martanesh,Çermenikë dhe Gollobordë, zona malore e Korcës

Këtu mund të përmendim zonën e Alpeve Shqiptare (Theth, Valbonë, Lëpushë, Vermosh, etj); zonën Topojan-Shishtavec në Kukës; dhe Ersekës (Morava, Mali i Thatë, Gramozi, etj); mali i Tomorit; Llogara-Karaburuni, etj.

1. Bazuar në potencialet natyrore që Shqipëria disponon bëhet e mundur zhvillimi i një disa llojeve të turizmit të aventurës në vendin tonë si ato të zhvillohen në tokë (ecjet në natyrë (hiking), trekking, alpinizmi, çiklizmi malor, garat Really 4*4, ski, kalërimi, gjuetia e egër, etj), në ujë (kanoe, rafting, kayaking, zhytjet në ujë, peshkimi, etj); në ajër (hedhjet me parashutë, etj).Disa nga destinacionet më të frekuentuara nga turistët dhe me promovim të vazhdueshëm të operatorëve turistik, të cilët I kanë përfshirë dhe në guidat turistike, janë:*Hiking***:** Jezerca,Maja e Hekurve**,** Razma, Munella në Pukë**,** Korabi, Radomira**,** Lura **,** Biza në Tiranë**,** Maja e Çikës**,** Mali i Tomorit**,** Gjinari në Elbasan**,** Maja e Rungajës në Vithkuq**,** etj.

2. *Trekking***:** Dukat**,** Mali i Çikës**,** Kurvelesh**,** Vermosh**,** Theth**,** Razem**,** Bogë**,** Valbonë,Tomorr**,** Vithkuq**,** Voskopojë**,** Drenovë

Harta nr.2: Lokacioni i destinacioneve kryesore të turizmit të aventurës në Shqipëri (hiking dhe treking)



Përpunimi hartografik: F.Pazari

3. *Çiklizmi malor*

Interesi për çiklizmin malor, si formë e turizmit të aventurës po fiton gjithmonë dhe më shumë vëmendje. Turet e biçikletave malore nëpër zona të cilat kanë një shkallë vështirësie po vjen gjithmonë e në rritje. Operatorët turistik si dhe guidat turistike locale në bashkëpunim dhe më zyrat e zhvillimit të turizmit nëpër bashki, po bashkëpunojnë për mundësitë e organizimeve të tureve të ciklistëve malor. Këtu mund të përmendim turet në Alpet shqiptare, turet në malësitë e Dibrës (Lurë dhe Korab, etj).

4. *Kalërimi*është një sport i cii ka një historik zhvillimi në Shqipëri.Shkodra, Durrësi, Tirana, Elbasani (Cërrik), Korça, Divjaka, Berati, Vlora, Fusha e Pelave në Lurë, Shishtaveci në Kukës, etj, janë disa nga zonat që kanë qenë të njohura për garat me kuaj dhe kalërimet. Ky lloj sporti vijon të mbeëtet traditë në vendin tonë, ku çdo vit organizohen gara me kuaj si në veri dhe në jug të vendit, ku pjesëmarrës janë si garuesit Brenda vendit ashtu dhe të huajtë.

5. *Sportet e ujit*(kanoe, kayaking, rafting, zhytjet nënujore, etj): Kanionet e Osumit, Riviera Shqiptare, lugina e Vjosës, lumi Buna, liqeni i Ohrit, liqeni i Shkodrës, liqeni i Komanit, liqeni i Ulzës, liqenet e Lurës, etj.

6. *Sportet e ajrit* (hedhja me parashutë): Llogara, Moravë, Dajt, Tarabosh, etj.

VIA DINARICA – DESTINACIONI MËI RI I TURIZMIT TË AVENTURËS NËSHQIPËRI

Via Dinarica

Via Dinarica i referohet zhvillimit të turizmit të aventurës që lidh vendet e Ballkanit Perëndimor nga Sllovenia në Shqipëri (Sllovenia, Kroacia, Bosnja Hercegovina, Monetegro, Shqipëria). Ai përfshin tre shtigje: Shtegun e Bardhë, Shtegun Blu dhe Shtegun e Gjelbërt. Shtegu i Bardhë është shtegu kryesor që ndjek rrjedhën natyrore të majave më të larta të Alpeve Dinarike, nga i cili ka marrë dhe emrin. Ndonëse gjurmët e këtij shtegu përfshijnë një sërë aktivitetesh të ndryshme në natyrë, të tilla si biçikleta në mal dhe rafting, funksioni i saj kryesor është ecja në natyrë, që ndryshe njihet si hiking si një. Ai ka një gjatësi prej 1930 km dhe përshkruhet në këmbë në një distancë kohore prej528 orë dhe 27 min. Maja më e lartë e këtij shtegu është Maja e Jezercës (2694 m) në Shqipëri, ndërsa maja më e ulët është Predjama (188 m) në Sllloveni. Rreth 51,8 km e kësaj shtegu janë në ngjitje dhe 51,7 km janë zbritje. Ky shteg ka një nivel të lartë vështirësie, sepse është i pjerrët dhe kërkon një rezistencë të lartë dhë përgatitje të fortë fizike. Periudha më e mirë e vitit për të ndjekur këtë shteg është nga maji deri në nëntor, për shkak të mungesës së borës. Aktivitetet përgjatë këtij shtegu përfshijnë hiking, çiklizëm, ski, kayaking, rafting dhe pothuajse çdo lloj tjetër të turizmit të avennturës që mund të zhvillohet në tokë, ujë dhe ajër. Via Dinarica synon krijimin e një lidhje tëmidis qyteteve dhe komuniteteve rurale në rajon, të rrisë ndërgjegjësimin për praktikat e mira të biznesit dhe mbrojtjen e mjedisit dhe të ndihmojë një ofertë të lulëzuar të turizmit të aventurës në rajonin e Ballkanit e mbështëtur në natyrë, traditë, produktet tradicionale vendase dhe trashëgiminë e saj unike kulturore.

Harta nr.3: Shtrirja Gjeografike e shtigjeve të Via Dinarica

Burimi: Regional Cooperation Council

Via Dinarica në Shqipëri

Shtegu i Bardhë iVia Dinarica në Shqipëri është një nga zonat më tërheqëse dhe magjepsëse në vend. Bukuria e tyre natyrore dhe vlerat unike mund të konsiderohen si një thesar i fshehur që kërkon kujdesin dhe mbrojtjen e të gjithëve. Alpet shqiptare (pjesë e Via Dinarica) janë shtëpia e një larmie interesante të bukurive natyrore dhe sigurojnë një habitat për shumë specie të botës së egër. Zona ka një klimë mesdhetare kontinentale, e karakterizuar nga dimër të ftohtë dhe verë të shkurtër dhe relativisht të freskët. Reshjet e borës në dimër arrijnë mesatarisht deri në 60 centimetra, madje edhe gjatë muajve të verës copa dëbore janë të dukshme në majat e maleve.Këto zona janë të pasura me burime ujore,

me disa lumenj si Valbona, Shala, Cemi dhe Kiri, të cilët kanë një regjim tipik alpin. Liqenet janë kryesisht me origjinë akullnajore dhe për këtë arsye janëtë varfër në specie. Lloji më i zakonshëm i bimësisë është pylli i ahut, pyjet e lisit, bredhat dhe bredhat, dhe pyjet e ahut. Në disa raste, bashkësitë bimorepasuritë floristike përfshijnë si specie endemike ashtu edhe subendemike. Llojet e pasura dhe të larmishme të bimëve të zonës i përkasin llojit të bimësisë kontinentale të Evropës Qendrore. Pemët e lisit zakonisht gjenden në lartësi midis 800 dhe 1,100 m; në lartësitë midis 1,200 dhe 1,800 m mbulesa e bimësisë përfshin pyje ahu dhe halore; ndërsa kullota alpine është tipike mbi 2.000 m. Kjo zonë është shumë e pasur me bimë të egra medicinale dhe aromatike, të cilat kërkohen në tregun ndërkombëtar. Shpellat karstike, të cilat janë një pjesë relativisht e panjohur dhe e paeksploruar e Alpeve, formojnë një habitat unik veçanërisht për lakuriqët e natës.

Bazuar në pasuritë natyrore si dhe vlerat që përmbajnë, një pjesë e konsideruashme e territorit të Alpeve të Shqipërisë janë të shpallura Zona të Mbrojtura, sipas kategorive tëIUCN-së si: Rezervat Strikt Natyror (Kategoria e Parë - Lumi Gashi), Parku Kombëtar (Kategoria e Dytë - Thethi dhe Valbona), Monumentet e Natyrës (Kategoria e Tretë - mbi 25 Monumente Natyre) dhe dy parqe rajonale të natyrës, Nikaj-Mërturi (17,505 ha) dhe Shkreli (20,282 ha), u shtuan në zonat e mbrojtura në Alpe.

Llojet e sporteve të aventurës përgjatë Via Dinarica në Shqipëri

Përgjatë shtegut të Bardhë të Via Dinarica në Shqipëri mund të zhvillohen një sërë aktivitetesh outdoor për atë grup turistësh të apasionuar pas adrenalinës dhe aventurës. Disa nga këto lloje sportesh dhe itineraret e tyre janë të listuara më poshtë:

1. *Hiking dhe treking*

Ecja në natyrë (hiking) dhe treking përgjatë Via Dinarica në Shqipëri kombinon ecjen në natyrë me eksplorimin e kulturës autentike vendase. Përgjatë këtij turi kalohet nëpër Parkun Kombëtar të Thethit dhe Valbonës, me vlera të larta biologjike, ekologjike dhe gjeomorfologjike.

Disa nga majat e lartë të cilat përshkohen përgjatë këtij turi janë: Jezerca, Maja e Hekurave, Razma, Lepusha, Maja e Rosit, Maja e Pojanikut, Vermosh, etj Shtigjet të cilat mund të ndiqen përgjatë këtij turi janë:Tiranë – Shkodër – Vermosh; Vermosh - Pojanic – Vermosh;Vermosh – Gusinjë;Gusinjë - Liqeni Buni i Jezercës - Maja e Jezercës –Theth;Vermosh – Lëpushë – Theth;Theth – Syri i Kaltër – Theth;Theth – Qafa e Valbonës – Valbonë; Valbonë – Quku i Dunishtës – Gjakovë; Valbonë – Maja e Rosit – Valbonë; etj.

2. Çiklizmi malor

Çkilizmi malor është një sport interesant që zhvillohet gjatë Via Dinarica. Ai është I kombinuar me shitgjet që ndiqen gjatëhiking dhe trekking. Zonat më të zakonshme që zhvillohen këto ture janë Thethi, Boga dhe Vermoshi. Disa nga këto ititnerare janë:

- *Vermosh – fundi i luginës nëVelipojë - Vermosh*

Turi fillon në qëndër të Vermoshit, kalon përgjatë luginës së Vermoshit deri në fund të saj dhe rikthehen sërish në Vermosh. Ai ka një gjatësi 17 km dhe është tur 1 ditor. Rruga është e paasfaltuar dhe me shkallë të lartë vështirësie.

- *Shtegu Ivanaj (Selcë)*

Shtegu Ivanaj fillon në afërsi të fshatit Selcë dhe përfundon në ujvarësn e Selcës, me një gjatësi prej 2.5 kmThis biking trail is 2.5 km. Lartësia mbi nivelin e detit varion 683-1016 m dhe mund të kombinohet dhe me aktivitete të tjera siç janë hiking, garat e vrapimit dhe garat me kuaj.

- *Turi Pylli i Dobkut - Maja e Vajushes*

Shtegu Pylli I Dobkut-Maja e Vajushës shtrihet në zonën e Lëpushës, në afërsi të kufirit me Malin e Zi dhe ka një gjatësi prej 3.7 km. Lartësia mbi nivelin e detit varion 1300-1700 m dhe mund të ushtrohen dhe një sërë aktivitetesh të tjera në natyrë si hiking, gara vapimi, gara me kuaj, ski, etj.

3. Eksplorim i shpellave

Alpet shqptare kanë një perizash karstic, i cili njihet si njëmjaft i përhapur nëkëtëzonë si rezultat iformacioneve karbonatike dhe atyre evaporate. Format karstike më të përhapura në shkëmbinjtë karbonatikë janë luginat, shpellat, kone, puset karstike, etj. Shpellat karstike, të formuara si rezultat i tretjes nga ujërat sipërfaqësorë, veçanërisht ujërat e borës, kanë një interes të veçantë për speleologët. Në Alpet Shqiptare gjenden disa shpella, ku turistët e apasionuar pas speleologjisë, mund të eksplorojnë si: Shpella e Zezë, Shpella e Dragobisë, Shpella e Arapit, Shpella e Thethit, Shpella e Jubanit, Shpella e Muriqit, Shpella e Pusit, Shpella e Harapit, etj.

Forma të tjera të llojeve të turizmit të aventurës që mund të realizohen përgjatë shtegut Via Dinarica në Shqipëri janë: ski, ku ka terrene të përshtatshme për ndërtimin e qendrave të skive; peshkimi në lumenjt e Valbonës, Thethit, Shalës, etj; kanoe dhe kayaking në lumen e Valbonës, Thethit, Shalës, liqenin e Komanit, etj.

KONKLUZIONE

Mjedisi natyror i Shqipërisë ofron një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit, duke e renditur atë në një ndër sektoërët kyç të zhvillimit ekonomik në vend. Oferta natyrore e vendit, dominimi i relievit malor dhe kodrinor, pasuritë klimatike, hidrike si dhe të biodiversitetit, ofrojnë mundësinë e zhvillimit të një sërë aktivitetesh në natyrë si dhe zhvillimin e turizmit natyror. Promovimi i Shqipërisë si një destinacion turistik që nuk duhet humbur, ka rritur interesin e turistëve vendas dhe atyre të huaj për të vizituar këto destinacione.

Në kuadër të zhvillimit të turizmit, turizmi i aventurës është një nga format më të reja të turizmit në vend, ku turistët gjithmonë e më shumë po orientohen drejt llojeve të sportit të aventurësdhe aktiviteteve në natyrë. Disa nga format më tëpërhapura të turizmit të aventurës janë: hiking, trekking, alpinizmi, çiklizmi malor, rafting, kanoe, kayakin, kalërimet, hedhja me parashutë, zhytjet nënujore, eksplorimi i shpellave,

etj. Nisur nga ky trend zhvillimi, në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, një vend të veçantë zë zhvillimi dhe menaxhimi I destinacioneve turistike natyrore (Zonat e Mbrojtura, turizmi rural, turizmi I aventurës, ekoturizmi, etj). Ndonëse Shqipëria është e njohur tashmë për potencialet e turizmit të aventurës, me të gjithë format e zhvillimit të saj, është e nevojshme ndërhyrja nëpërmjet instrumentave përkatës, për zhvillimin e një produkti turistik sa më të plotësuar. Ndërhyrje të nevojshme duhen bërë në: shënjimin e shtigjeve natyrore për hiking, trekking, çiklizmin malor, etj; ruajtjen e produktit autentik kulturor të komuniteteve lokale; dixhitalizimi i shtigjeve dhe zhvillimi i aplikacioneve teknologjike për informacionin rreth këtyre itinerareve natyrore; përgatitja e guidave turistike të mirëinformuara dhe të specializuara për lloje të caktuara të sporteve të aventurës; sigurimi i jetës së turistit dhe dhënia e ndihmës së shpejtë në rast rreziku, etj.

Alpet e Shqipërisë, tashmë pjesë e projektit Via Dinarica, është ndër destinacionet më të frekuentuar nga turistët e aventurës, por informacioni për këto shtigje si dhe mënyra e organizimit të tureve ka mangësi, gjë e cila shpeshherë bëhet pengesë për shumë vizitorë të tjera që duan të eksporojnë këtë zonë. Nisur nga trendi aktual i kohës I orientuar drejt natyrës dhe aventurës, organizimi I aktiviteteve dhe sporteve me karakter aventuresk, shtimi i interest të turistëve që preferojnë të përjetojnë përvoja të reja dhe adrenalinë, shton përgjegjësinë e institucioneve menaxhuese dhe promovuese për dhënien prioritet këtij sektori, në mënyrë që Shqipëria të shëndërrohet në një treg konkurues rajonal të turizmit të aventurës. Në kushtet e pandemisë Covid-19, u vu re një ndryshim i preferencave të turistëve, duke iu shmangur turizmit të masës dhe duke preferuar zona malore dhe aktivitete të cilat ushtrohen në natyrë, gjë e cila e fuqizon akoma më shumë peshën mbi institucionet menaxhuese por dhe komunitetit lokal që jetojnë në këto zona.

LITERATURA

1. Agjensia Kombëtare e Turizmit, Shqipëria: Guidë Turistike, Tiranë 2015
2. Akademia e Shkencave, Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Volumi II, 1991
3. Albania Adventure https://albania-adventure.com/
4. Albanian Water Sports https://albanianwatersports.com/
5. Caravan Horse Riding Albania, https://horseridingalbania.com/riding-trails-albania/
6. Chong C., Litch C., Morton B., Ryan E., Determining Preferences for Activities at the Albanian Adventure Resort, fq.15
7. Cycling in Albania Guide, https://www.responsibletravel.com/holidays/albania-cycling/travel-guide
8. Kandari, O.& Chandra, A., Tourism, Biodiversity and Sustainable Development, Dehli: ISHA Books, fq.12
9. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Turizmit 2019-2023
10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Turizmit 2018-2022
11. Qiriazi P., Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Trashëgimia Natyrore e Shqipërisë, 2017, fq.18
12. Regional Cooperation Council, Adventure Tourism Industry Assessment, Sarajevo 2018, fq.12
13. Regional Cooperation Council, Via Dinarica, Connecting Naturally, 2019, fq.8

14. UNWTO, Travel & Tourism Council, Economic Impact Reports, Albania, 2019

15. UNWTO, Travel & Tourism Council, Economic Impact Reports, Albania, 2020